



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА  
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

### VENDIM

Veprimi ndaj lëndës me numër 12-2971/1 datë 03.06.2019, NDËRPRITET

Prokurorisë Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit, të dorëzojë iniciativë për ndjekje penale kundër personit zyrtarë, ///, kryetarit të komunës /// dhe kundër personit zyrtarë ///, inspektorit të autorizuar të ndërtimit në komunën e ///, për qëllim të sjelljes nga pakujdesia dhe shpërdorimit të pozitës zyrtare dhe kompetencave nga neni. 353-cv nen. 364 të Kodit Penal ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 37/96 ... 55/13).

Këshillit të Prokurorëve Publikë të RMV-së ti dorëzohet një iniciativë për përcaktimin e përgjegjësisë së personit zyrtarë ///, prokuror publik i Prokurorisë Themelore Publike ///, për shkak të mos marrjes së veprimeve dhe masave të nevojshme dhe zvarritjes së procedurës penale, në dëm të të dëmtuarit, sipas lëndës ///.

Komisionit për kundërvajtje në KSHPK ti dorëzohet Kërkesë për fillimin e procedimit penal kundër personit zyrtarë ///, kryetar i komunës///, për veprën penale të kryer në paragrafin 23. 3, e dënueshme sipas nen. 100 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Lënda me numër 12-2971 të vitit 2019 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimmarrjes.

### Arsyetim

Lënda me numër 12 - 2971 të datës 27.09.2019 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Më pas, denoncimi është plotësuar më datë 27.06.2019 nga avokati i parashtruesit- ///. Pretendimet e paraqitura në raport i referohen dyshimeve për mos marrje të veprimeve zyrtare nga ana e personave zyrtarë në Komunën ///, si dhe në lidhje me ndërtimin pa leje të objektit nga personi ///. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së kërkesës dhe provave të paraqitura, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga Komuna/// dhe marrjen e masave për ushtrimin e kompetencave të saj ligjore. Pas urgjencës së dorëzuar për veprim, Komuna e ///, në afatin e paraparë me ligj, nuk ka vepruar sipas kërkesës së KSHPK-së, për çka KSHPK-ja kryetarit të Komunës ///, person zyrtarë ///, në cilësinë e personit përgjegjës, i shqiptoi dhe dorëzoi urdhër pagese kundërvajtëse për shkelje të kryer të nenit. 23 rr. 3, e dënueshme sipas nen. 100 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit. Personi përgjegjës nuk ka vepruar sipas urdhërpagesës për kundërvajtje dhe nuk ka paguar gjobën, për çka KSHPK-ja është dashur të dorëzoi kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje Komisionit për Kundërvajtje.

KSHPK-ja kërkoi marrjen e masave nga Inspektorati Shtetëror Administrativ i RMV-së me rastin e mosndërmarrjes së veprimeve të nevojshme nga inspektori i autorizuar i ndërtimit në Komunë ///, personi zyrtarë ///. Inspektorati Administrativ Shtetëror i RMV-së e ka njoftuar KSHPK-në se inspektori i autorizuar ndërtimor i përmendur më parë në Komunë ///, ndonëse ka kryer mbikëqyrje inspektuese mbi kryerjen e veprimtarisë ndërtimore nga shtetasi i cekur në denoncimin e parashtruesit, pavarësisht paligjshmërive dhe parregullsive të konstatuara, nuk ka kryer inspektim kontrolli, për çka i është shqiptuar masa inspektuese Vërejtje dhe e ka detyruar të miratojë aktet brenda 7 ditëve të punës, të llogaritura nga dita e marrjes së vendimit për caktimin e masës së kontrollit. Për këtë arsye, KSHPK-ja iu drejtua sërish Komunës ///, nga ku kërkoi të gjitha dokumentet në lidhje me lëndën, të cilat ishin dorëzuar. Me këqyrjen në të dorëzuarën konstatohet se inspektori i autorizuar ndërtimor ende nuk ka marrë masat e nevojshme, përkatësisht nuk ka konstatim për largimin me forcë të ndërtimit pa leje. Në veçanti, inspektori i autorizuar ndërtimor ka konstatuar se personi i lartpërmendur është duke kryer ndërtim pa leje në mënyrë që nuk ka vepruar në përputhje me lejen e lëshuar të ndërtimit, ndaj ka urdhëruar personin e cekur në denoncim që ta largojë ndërtimin pa leje. Gjatë mbikëqyrjes kontrolluese është konstatuar se objekti pa leje nuk është hequr, andaj inspektori i autorizuar i ndërtimit i ka lëshuar urdhër personit të cekur nga denoncimi që objektin e ndërtuar pa leje ta largojë. Nga ai moment nuk janë ndërmarrë masa dhe veprime të mëtutjeshme, të cilat inspektori i autorizuar ndërtimor ka qenë i detyruar t'i ndërmarrë - konkluzion për ekzekutimin me dhunë të akteve për heqjen e ndërtimit pa leje.

Në lidhje me pretendimet për ndërtime pa leje, KSHPK-ja kërkoi informacion dhe të dhëna nga Prokuroria Themelore Publike ///, nëse ndaj personit që ka kryer veprimtaritë e ndërtimit pa leje po zhvillohet procedim penal. Prokuroria Themelore Publike ///, ka raportuar se në rastin konkret, pas hetimeve, prokurori publik kompetent, personi zyrtar ///, ka përgatitur aktakuzë kundër personit ///, për ndërtim pa leje, kështu që procedura është zhvilluar para Gjykatës Themelore ///. Mirëpo, me këqyrjen e dosjeve, KSHPK-ja konstatoi se nga data e dorëzimit të kallëzimit penal - /// deri në datën e hartimit të aktakuzës - ///, kanë kaluar pothuajse /// vite

, nga ku lind dyshimi se prokurori publik kompetent e ka zvarritur procedurën në dëm të parashtruesit.

Gjatë analizës së tërthortë të fakteve të lartpërmendura, KSHPK-ja konstatoi se as kryetari i Komunës /// dhe as inspektori i autorizuar i ndërtimit nuk kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme - për të bërë kallëzim penal kundër personit të dyshuar për ndërtim pa leje, dhe dëshmi për këtë është vetë aktakuza e përmendur më lart.

Nga rrethanat e konstatuara në këtë mënyrë, para KSHPK-së, ka lindur dyshimi se personat zyrtarë nga dispozitivi i këtij vendimi kanë bërë shkelje të ligjit në dëm të parashtruesit, për çka KSHPK-ja është dashur të vendos si në dispozitiv.

Dorëzuar deri te:  
Parashtruesi i denoncimit  
prokurorinë publike themelore për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionit  
këshillit të prokurorëve publikë të RMV-së

Përgaditi: Mr D. D.  
Miratoi: Mr.Sh. S.

KOMISIONI SHTETËRORË  
PËR PARANDALIMIN E KORRUPTIONIT  
KRYETARE,  
Biljana Ivanovska

